
KONTRATË
PËR TRANSFERIM KUOTASH PA KUNDËRSHPËRBLIM

Sot më datë 7/12/2023 bazuar në nenet 73 e në vijim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar nënshkruhet kjo Kontratë për Transferim Kuotash pa Kundërshtëpërblim (“Kontrata”) ndërmjet Palëve të mëposhtme:

Neni 1
Palët Kontraktuese

- A. Shoqëria **“Le Spot Group” SHA**, me NUIS K91413013O, në cilesinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “Spot Communications” SHPK me ortak të vetëm zj. Mirza Alibegaj, përfaqësuar nga Administratori Vilma Maze nga këtu e më poshtë referuar si **“Dhuruesi”**

dhe

- B. **Selena Kurti**, shtetase Shqipëtare, e lindur në Tiranë, Shqipëri, e datëlindjes 09.08.1971, e identifikuar nga Letërnjoftimi me Nr. Personal H15809145K, madhore me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, nga këtu e më poshtë referuar bashkërisht si **“Pranuesi i Dhurimit”**.

Neni 2
Objekti i Kontratës

- 2.1. Objekti i kësaj kontrate, është dhurimi prej Dhuruesit kundrejt Pranuesit të Dhurimit e një pjese të kapitalit që shoqëria Le Spot Group SHA zotëron në shoqërinë “Spot Communications” SHPK, e konkretisht:
- a. Dhurimi i 2 % të kuotave që Shoqëria “Le Spot Group” SHA ka në cilesinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë “Spot Communications” SHPK, kundrejt zj. Selena Kurti, me vlerë 6,000 ALL (gjashtë mijë leke);

Neni 3
Transferimi i kuotave pa kundërshtëpërblim

- 3.1. Dhuruesi shpreh vullnetin e lirë për transferimin pa kundërshtëpërblim (dhurimin) tek Pranuesi i Dhurimit.
- 3.2. Pranuesi i Dhurimit shpreh vullnetin e tij për pranimin e kuotave nëpërmjet dhurimit.
- 3.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Ortakë të shoqërisë “Spot Communications” SHPK, do të jenë:
- a. Shoqëria **“LE SPOT GROUP” SHA**, zotëruese e 98 % të kuotave të shoqërisë me vlerë nominative prej 294.000 Lekë;
- b. Zj. Selena Kurti, zotëruese e 2% të kuotave të shoqërisë me vlerë nominative prej 6,000 Lekë;

Neni 4
Garanci të Dhuruesit

- 4.1. Dhuruesi garanton se kuota (kapitali) objekt dhurimi i kësaj kontrate, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 4.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi atë pjesë të kapitalit që është objekt Dhurimi sipas kësaj kontrate, kapital që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon në raportet e cituara në nenin 2 të kësaj kontrate.

Neni 5
Garanci të Pranuesit të Dhurimit

- 5.1. Pranuesi i Dhurimit pas nënshkrimit të kësaj kontrate ka të drejtë për të përfituar cdo dividend të mundshëm, si rezultat i kapitalit që ata do të zotërojnë në shoqëri, por nuk do të ketë të drejtë të marre pjesë në procese të tjera vendimmarrje brenda shoqërisë deri në 31 Dhjetor të vitit 2029. Në cdo rast, Pranuesi i Dhurimit do të jetë përfitues të dividendit vetëm në ato raste kur asambleja e ortakëve në përputhje me dispozitat e ligjit, merr vendim për shpërndarje dividendi.
- 5.2. Nëse Pranuesi i Dhurimit vendos të tjetërsojë kuotat e përfituara sipas kësaj kontrate, tek palet e treta, ai do të jete i detyruar të respektojë fillimisht të drejtën e parablerjes nga Ortaku Maxhoritar Shoqëria "Le Spot Group" SHA. Pranuesi i Dhurimit gjithashtu nuk ka të drejtë të vendosi barrë apo hipotekë mbi kuotat e tij pa miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

- 6.1. Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 6.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Shoqëria "LE SPOT GROUP" SHA

Vilma MAZE

Vilma Maze

Le Spot Group SH.A

NUIS: K 91413013 O

BLERËSI

Selena KURTI

Selena Kurti